

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

KLOTILDA MARGJEKA

SIMBOLIKA E RAPORTIT NATYRË-VDEKJE NË PROZAT E SHKURTRA TË E. KOLIQIT DHE M. CAMAJT

Strukturimi i punimit të tezës doktorale, do të bazohet mbi analizën e tekstit dhe mbi planin krahasimtar mes disa autorëve të ndryshëm mbi të njëjtën temë universal :vdekjen. Kam zgjedhur një ndër çështjet me titull: “Simbolika e raportit natyrë-vdekje në prozat e shkurtra të E. Koliqit dhe M. Camajt” që ka si synim marrëdhënien simbolike të vdekjes me elementet natyrore (malin, detin, lumin, rrungajën, shiun, etj.), përkatësisht tek “Hija e Maleve”, “Rrungaja në mars”, “Shkundullima”, etj. Ky lloj paralelizmi merr nuanca universale që vijnë nëpërmjet ngjarjes, kohës, hapësirës dhe mitit. Vdekja në këto proza vjen nga pamundësia për ta jetuar jetën në të gjitha dimensionet e saj si pasojë e rrethanave natyrore të cilat e çojnë jetën në zgrip të ekzistencës. Strukturimi i këtij punimi të shkurtër ngrihet mbi disa pika analizuar të përbashkëtën mes dy autorëve që është “forma e vdekjes”.

NATYRA DHE VDEKJA NË PROZAT E M. CAMAJT

a) Jeta dhe hapësira

Për t’iu qasur këtij lloj këndvështrimi që Camaj ka për vdekjen, po ndalemi brenda kontekstit hapësinor të zhvillimit të ngjarjeve. Në mjedisin verior të përshkruar nga Camaj, kohë kur mbizotëron tradita e asaj kohe, jeta në “katund” (siç e quan Camaj), shkon drejt zbehjes dhe lodhjes nga rropatja për ta jetuar atë. Koha e ndodhjes së ngjarjeve vendoset në stinën e dimrit dhe pranverës që simbolikisht lidh kapërcimin e rënies morale, plogështisë së të menduarit me sforcën për ta kapërcyer atë, si nevojë shpirtërore që vjen natyrshëm me ndryshimin e stinëve. “Rrungaja në mars” e tematizon fundin e dimrit dhe fillimit të pranverës por për të mbetur në mes, e pakapërcyer shpirtërisht dhe fizikisht. “Katundi arbëresh” tek “Shkundullima” ndodhet mes malit dhe detit, të cilat përplasen heshtur me njëri-tjetrin, ndryshe nga “Rrungaja...” apo “Pishtarët e natës”, ngjarjet i kanë të vendosura brenda relievit malor mes vërrinit dhe bjeshkës, mirëpo këto dukuri tek Camaj nuk sjellin progres tek njeriu sepse kanë mbetur brenda traditës, varfërisë dhe mentalitetit të kohës. Me fatin tragjik të Jerës tek “Rrungaja në mars”, bashkohet edhe ai i Florës tek “Fshati me gjuhë të fshehtë”, një ish farmacist, jeta e së cilës mbyllet me vdekjen e të shoqit. Ajo mendon se nuk duhet të martohet më për hir të mentalitetit dhe mbetet e vetme përjetë për të pritur vdekjen. Nika tek “Pishtarët e natës” largohet nga realiteti nga turpi që ndjente nga gruaja, djemtë, vëllezërit dhe fshatarët e tjerë për lindjet e vazhdueshme të fëmijëve. E shoqja ndihej keq jo vetëm nga turpi, por edhe nga lodhja e lindjeve të shpeshta. Kështu Nika për ta shuar këtë vendos të largohet nga familja për të jetuar në Fundimë, një vend i vetmuar ku gjen dhe vdekjen.

b) Raporti i personazheve me natyrën dhe vdekjen

Fjalët kyçe si: **Fundinë, Përroi i thatë, Përtejqafa, Shkundullima, Rrungaja, Gurra malore, humnera, bora, bjeshka, vërrini, deti**, etj., shërbejnë jo vetëm për të kuptuar vendin e zhvillimit të ngjarjeve, por edhe si çelës zbërthyes i raportit mes jetës së personazheve me natyrën. Natyra merr rol zotërues në jetën e personazheve duke e bërë shpesh të pamundur atë. Përpykja e njeriut për ta zotëruar atë është jo vetëm e pamundur por edhe katastrofike, e cila shndërrohet simbolikisht në forcë hyjnore. Ajo ndërvepron me të gjithë elementet e saj. Mali, simbol i lashtë, miti i qëndresës, pika e referimit të shumë shkrimtarëve herë për ta larguar e herë për të gjetur qetësinë, tek Camajt merr nuanca negative. Objekt referimi për autorin është katundi. Elementet qytetëruese pothuajse nuk janë të pranishme ose janë mjaft të zbehta si: shkollimi i Jerës, Dakut apo Vitoit i cili nuk përbën ndihmon aspak jetët e tyre. Ata mbeten po në katund për të mos dalë më prej tij... Mali në prozën e Camajt bashkëvepron me të gjithë elementët e tjera natyrore: shiun, borën, përmytjet, etj. Këta elemente marrin trajta negative sidomos në stinën e dimrit, fundin e vjeshtës apo ardhjen e pranverës të cilët u krijojnë personazheve vështirësi morale dhe fizike. Por, prozat e Camajt ngërthehen edhe mes dikotomisë mal – det, borë – shi, për të sjellë “mordjen”, vdekjen. Mali mbart borën mbi vete për tua shkarkuar gjësë së gjallë, kurse deti shpërthen nga shiu, tërbohet dhe merr me vete çdo jetë që i del përpara. Përmytjet natyrore dhe prania e vdekjes janë sfondi i tyre i përbashkët. “Rrungaja...” e tematizon që në titull fundin, po ashtu edhe “Shkundullima”, ndërsa prozat e tjera e nisin me një paralajmërim tronditës, me një simbolikë rrëqethëse dhe e përfundojnë me vdekje...

HIJA E MALIT: SIMBOL I PËRNDJEKJES SË JETËS SË PERSONAZHEVE**b) Mali, jeta dhe vdekja në raport me tyre**

Edhe tek Koliqi mjafton të bëjmë një klasifikim të shkurtër të disa termave për të kuptuar lidhjen mes këtyre elementëve: **Hija e maleve, prroni, deti, gurë të thepisun, kanuni i maleve, Qafa e barijeve, shtojzovallet, zanat, gjakmarrja, etj.**

Përmbledhja e novelave të Koliqit me titull “Hija e maleve” është një titull simbolik i ndërtuar me dy komponentë mali, dukuri natyrore dhe hija mistike e maleve të Veriut, traditës, dokeve e zakoneve. Edhe ngjarjet tek Koliqi janë vendosur në Veri, mes malësorësh. “Nusja e mrekullueshme”, është novela me të cilën hapet ky vëllim. Ngjarjet e saj zhvillohen në mjedisin e maleve, realitet që prek banorët e pjesës së Veriut të Shqipërisë ku nëpërmjet figurave mitike simbolizohet ashpërsia e këtij realiteti. “*Ajo (nusja e mrekullueshme), përcakton përgjithësisht karakteristikën e subjektin e librit të parë të Koliqit për t’i qëndruar besnik si përmbajtje e mjedis skenik titullit të parapëlqyer.*” f. 11.)¹ Pra, novela përbëhet nga realiteti i hidhur malor i ndjekur nga hijet mistike të tij. Leka ashtu si personazhet e Camajt kërkon vetminë në male, aty ku dashurohet me hijen,

¹ Shënim nga Leka Ndoi, në *Hija e maleve*, E. Koliqi, *Pakti*, 2011, f. 11.

Simbolika e raportit natyrë-vdekje në prozat e shkurtra të E. Koliqit...

shtojzovallen. Kjo e fundit bëhet shkak për t'i prerë të folurën Lekës sepse Leka nëse i tregonte qoftë edhe një njeriu të vetëm për lidhjen e tij me shtojzovallen, do të humbiste gojën përgjithmonë. Doda tek novela "Gjaku" nuk i shmanget dot elementit rrënjor, kanunit të maleve, hijes së tij pavarësisht luftës me ndërgjegjen e vet. Në këtë rast mali "vret" duke qenë se kanuni i maleve e lejon vrasjen por, edhe hakmarrjen. Hija e malit depërton në ndërgjegjen e Dodës për ta mposhtur vullnetin e tij, për ta çuar drejt vdekjes... Nëse Leka tek "Nusja e mrekullueshme" është personazh që i përket totalisht malit sa i përket botëperceptimit të jetës, kurse Doda është i dyzuar mes mendësisë qytetare, emancipimit të fituar në shkollë dhe fshatare, pra kanunit të maleve.

*"Ai është qytetari që nuk do ti duhej kurrë të mbërrijë deri tek dilemat e gjakut."*² f. 85. Doda nuk i shpëton hijes së maleve që e ndjekin në çdo veprim e mendim të tij si hije që merr jetë. Në momentin final të vendimmarrjes së Dodës, natyra ngërthehet fort me të. *"...ra shiu; i fortë, i shpejt, i kumbueshëm. Mandej vetimat u rralluen, bubullimat u larguen e ktheu heshtja e përparshme. Dodës i ra në kujtim se kishte lexue një libër...Natë e shkambije."* Ai ikte turrshëm tue u shqye petkash nëpër gurë të thepisun. Ndiente në trup randim..." f. 42. Hija e malit depërton në ndërgjegjen e Dodës për ta mposhtur vullnetin e tij, për ta çuar drejt vdekjes... Këtu mali ngërthehet me elementin e ujit. Këto dukuri veprojnë në ndërgjegjen e Dodës, të cilat po e ndjekin në çdo mendim apo veprim. Turrshëm binte shiu, turrshëm rendte dhe Doda nëpër shkëmbinjtë e thepisur.

Tek Novela "Miku", kanuni i maleve i detyron familjet ta presin gjaksin për hir të mikpritjes por, në këtë rast zgjidhja/zgjedhja vjen natyrshëm, fillon me pritjen e gjaksit në shtëpi. Atmosfera përbëhet nga "hija e maleve" ku personazhet e njohin hapësirën e maleve por jo përndjekjen e hijes që do shkaktojë helm.

"Kishin ecë ma se një orë nëpër teposhtë malit kur Uc Lleshi u ndal e u tha të bijve:

- Jue të dyve po u ve në roje këtu, tu Shtegu i Barijve." f. 84. Atmosfera është e ndërtuar në male për të dhënë detaje mbi emrat e pjesëve të tij. Tragjedia tek novela "Diloka" ndodh pranë një prroni ku simboli i ujit (prronit), del si element në nevojë që mbron dashurinë por, "hija e malit" është ajo që transformon ndjenjën dhe e çon jetën në skaj të ekzistencës.

MALI SI SIMBOL I PERNDJEKJES

Funksioni i malit në prozat e autorëve është element i pashmangshëm jo vetëm në strukturën e tekstit por edhe në mendësinë e vetë autorëve dhe të personazheve. Tregimet e Koliqit karakterizohen nga të rrëfyerit e jetës kanunore, nga kanuni i maleve kurse të Camajt nga mentaliteti i katundit të veriut, karakterizuar nga veçoritë stinore të tij. Vdekja tek "Rrungaja..." vjen nga një ortek bore që rrokullisej nga maja e malit kurse tek "Pishtarët e natës" Nika e prët vdekjen në bjeshkën malore i vetmuar. Vetë Camaj e konsideron vdekjeprurës malin: *"Ishte depresioni i natyrës malore që kalonte prej dheut e bimësisë së*

² Dh. Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, 2006, f. 85.

mbytun e marrun fryme...”. Mali bashkëjeton me personazhet duke ndjekur ndërgjegjen dhe psikologjinë e tyre derisa u merr jetën. “Hija e maleve” e Koliqit është një titull simbolik që përbëhet nga dy komponentë “mali” si simbol i qëndresës dhe “hijes” së tij si bashkëshoqëruese e individit. Hija e tij e mbyt Dilokën pranë një prroni kurse mikut tek novela “Miku” i shkakton helm. As Doda tek novela “Gjaku” nuk i shpëton hijes së malit i cili vërtitet rreth ndjenjave dhe vendimeve të tij për t’i marrë jetën ashtu siç vetë shprehet Koliqi “Mali asht kalesa qi ka rranzat e shtrime thellë në tokë të të parëve”.

ELEMENTI UJE: DETI DHE LUMI

Simboli i ujit është një ndër elementet më të rëndësishme njerëzore të cilin autorët e kanë përdorur në mënyra të ndryshme qasjen dhe nënshtrimin e tij ndaj artit letrar. Si përbërëse e dytë kryesore e simbolikës natyrore, uji paraqitet herë si element në mungesë e herë në tepri. Kjo sjell dyzimin shpirtëror brenda individit i cili mbijeton me luftën e shfrenimit të universit natyror duke përçuar mesazhin e pamundësisë për tu përballur me të. Doda ndodhet i dyzuar jo vetëm brenda vetes por edhe brenda natyrës :malit dhe detit pra ujit si simbole të kundërta konceptuale. Në këtë kontekst Diloca fshihet pranë një prroni (uji) me të dashurin jo vetëm fizikisht por kërkon t’i shmanget një pengese që se kapërcen dot. Elementi ujë në këtë rast është një udhërrëfyes ashtu siç do të jetë edhe për mikun tek novela “Miku” i cili këndvështrimin për botën e vet e paraqet buzë prronit. Novela përfundon me kapërcimin e tij si simbol i kapërcimit nga një botë në një tjetër. Tek Camaj personazhet nuk e kapërcejnë “ujin” përkundrazi në hyrje të pranverës dhe vjeshtës frika ndaj ciklit stinor vjen si element i pashmangshëm por edhe i pritshëm kështu që në shumicën e rasteve personazhet e ndiejnë dhe e presin furinë e tij e cila u merr jetën. Vitoi përpiket të sjell ndryshimin jo vetëm në mentalitetin e individit por edhe të dukurive të përsëritshme natyrore gjë që rezulton e paarritshme për të.

PARALELIZMI I DUKURIVE TE NATYRES ME PERSONAZHIN

Kujtesa dhe ndjesia e autorëve është pasqyruar në marrëdhënien e personazheve me jetën. Si moment definitiv i jetës, vdekja është pikë referuese, artistike e shtjellimit të ngjarjeve si simboli më enigmatik që ka shoqëruar njerëzimin. Figurativiteti i natyrës i jep ngjyrim emocional, ndiesor kontekstit brenda një situatë të tillë tragjike. Personazhet e Camajt dhe Koliqit brenda tyre e ndiejnë si forcë dhe si pengesë njëkohësisht dukuritë e natyrës, një luftë kjo brenda psikologjisë personale. Tipologjia e tyre ndiesore vërtitet rreth elementeve të natyrës si pararendëse e tyre universale.

Në pamundësi për të depërtuar në elemente konkrete të gjindshme në tekste dhe të ilustruara me veçori përkatëse dhe detaje simbolizuese, prekëm panoramën e rëndësisë simbolizuese dhe natyrore të dy elementeve rreth të cilëve vërtitet teksti: vdekjes dhe natyrës.

KONKLUSIONE

(Të përbashkëta dhe dallime mes tematikës së dy autorëve)

E përbashkëta mes të dy autorëve nuk është vetëm qasja ndaj të njëjtës tematikë por, edhe mënyra se si vdekja vjen tek personazhet e tyre. Ata i referohen

Simbolika e raportit natyrë-vdekje në prozat e shkurtra të E. Koliqit...

të njëjtit ambient, të njëjtave dukuri natyrore por, mënyra se si vdekja vjen është e ndryshme jo vetëm sa i përket rrëfimit por, edhe përshkrimit për ngjarjen dhe mendësinë e personazheve. Personazhet e Koliqit e përcaktojnë vetë fatin e vet domethënë, njerëzit e kanë krijuar kanunin e maleve, e kështu dhe vdekja vjen më e pritur. Tek Koliqi veprimi është mbizotërues pra, nuk kemi shumë emocione, përshkrime, ndjesi, ndryshe nga Camaj ku ndërveprimi psikologjik i personazheve ndërvarët nga përshkrimi i dukurive të natyrës. Pra, kemi vënë në dukje disa të përbashkëta ku strukturimi i teksteve tek të dy autorët vërtitet rreth simbolikës së elementeve të natyrës.

LITERATURA E SHQYRTUAR

- M. Camaj (1996), *Vepra letrare 4*, Apollonia.
E. Koliqi (2011), *Hija e Maleve*, Pakti.
Dh. Shehri (2006), *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri.
T. Todorov (1986), *Poetika e prozës*, Panteon.
Studime Albanologjike, (2013/2), *Si vdesin personazhet në letërsinë shqipe*, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.
J. Borges (2013), *Ligjërata*, Pika pa sipërfaqe.
R. Wellek & A. Warren (2007), *Teoria e Letërsisë*, Onufri.
U. Eco (2007), *Për letërsinë*, Dituria.
M. Calinescu (2012), *Pesë fytyrat e modernitetit*, Dituria.

